ADEM ZAPLLUZHA

TRENAT KËTU GJITHMONË VONOHEN

Redaktor:
Kujtim Mateli

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

TRENAT KËTU GJITHMONË VONOHEN

"TREND"
2017

Parathënie

Adem Zaplluzha -Rilindësi i kohëve moderne

Nga Kujtim Mateli

Pasi përfundova leximin e këtij vëllimi poetik **"Trenat këtu gjithmonë vonohen"** në mendje më erdhi thënia e filozofit antik se me shkrimtarët ndodh ajo që hasim me orakujt dhe profetët, të cilët i përcjellin mesazhet e tyre të larta pa e ditur fare kuptimin e tyre. Që do të thotë se ata i përcjellin mesazhet e tyre jo me arsye, por me ndjenjë e zemër, e cila vështirë se mund të shpjegohet në kontaktin e saj të parë me lexuesin. Ajo që ndodh me poezinë, ka ndodhur dhe me orakujt. Mjaftojmë të kujtojmë orakullin që Dodona nxori për athinasit. Ky orakull u bë pjesë e jetës publike të Athinës dhe depërtoi edhe në jetën politike të saj. Oratori i famshëm i antikitetit, Demosteni e përdorte orakullin e Dodonës për të sulmuar kundërshtarët e vet. Nga ana tjetër Dinarkus dhe grupimi i tij, i përgjigjeshin Demostenin pikërisht me orakullin e Dodonës. Dhe publiku dëgjonte si njërin grupim politik ashtu dhe tjetrin në dhjetëra takime dhe kërshëria nuk

shteronte.

Po ta lexojmë sot atë katërvargësh të orakullit të Dodonës, do të nxjerrim mesazhe të reja; shohim gjithashtu se ai është një krijim artistik. Si orakujt dhe poezia i janë drejtuar dhe i drejtohen individit dhe shoqërisë duke i përcjellë mesazhe sa tokësore aq dhe qiellore, sa të prekshme dhe të kuptueshme aq dhe hyjnore e misterioze për të. Duke lexuar një krijim artistik ne shohim një pjesë të dritës që bie në shpirtin tonë. Po njeriu kërkon të tërën. Ndaj krijimet e bukura artistike lexohen e rilexohen vazhdimisht me synimin për të arritur tek burimi i dritës.

1

Elementët e natyrës dhe të shpirtit njerëzor formojnë materialin bazë mbi të cilën ndërtohet poezia e Adem Zaplluzhës. Poeti nuk mund ta kuptojë dot ekzistencën e qenies njerëzore pa natyrën. Të dy bashkë formojnë universin ku lëviz bukuria e natyrës e pleksur me bukurinë e shpirtit njerëzor. Tek poezia **"Nga sytë e plepave"** elementi natyrë është vendosur në stinën e dimrit. Ajo pikturohet me elementë të qenies njerëzore. Plepat që simbolizojnë drurin shtatlartë i përcjellin tokës, si një lloj trishtimi, dhembjen e qiellit. Edhe plepat kanë sy, nëpërmjet të cilëve përcillet ndjeshmëria e natyrës e ku sipër tyre qëndrojnë qerpikët e mjegullave. Si mund të përcillej më bukur një ditë

me shi. Si mund të kombinohej më bukur ajo çfarë një qenie njerëzore ndien në këtë mjedis të natyrës që përcillet si një trishtim.

“Retë e plumbta
Pikonin mbi çatitë e rrënuara
Pikonin si loti i egër
Zëra fjalësh mbi përditshmërinë”.

Tematika e poezisë së Zaplluzhës është e gjerë, ajo kap përmasat e shqetësimeve të individit dhe të shoqërisë. Aty është fati i atdheut në udhëkryqet e historisë dhe në udhëkryqet e kohërave që vijnë. Ky shqetësim e ka zgjeruar dimensionin e hapësirës së letërsisë shqipe. Ndaj ajo lexohet me ëndje në çdo cep të rruzullit, kudo ku ka shqiptarë. Janë shqetësimet e individit shqiptar dhe të shoqërisë sonë të përcjella estetikisht nëpërmjet vargut dhe poezisë zaplluzhiane. Figuracioni brilant e xixëllonjës përshkon çdo poezi të tij.

“Më duket se na mësuan të heshtim
Heshte edhe gjelbërimi
Kosa e fjalëve

Ishte fshehur mes luadheve të imagjinatës”. (poezia ***“Sa herë kishim uri*)**.

Me nota drithëruese është përshkruar tek poezia **“ Asnjë njeri nuk qante”** ikja nga toka mëmë e bijve dhe e bijave. Dhimbje për çfarë lë pas, dhimbje për njerëzit, madje dhe për mjegullat dhe lejlekët, të shoqëruar nga shirat e pandërprera që binin mbi flokët e trishtimit. U thirr gjithçka për të qenë të pranishëm në këtë largim, madje dhe gurët dhe drurët e malit.

“Binte një shi imcak atë ditë
Binte pa ndërprerë mbi flokët e trishtimit”
Dhe asnjë përpjekje për ta ndalur këtë eksod masiv ikjesh. Duke ndenjur duarkryq:
“Shikonim barin që rritej
Rritej si dhembja jonë e pashëruar”

2
Tek poezia **“ Unë s`jam çam as kosovar”** poeti i përgjigjet një realiteti të ri të krijuar pas çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb. Dihet që në fillim të shekullit të kaluar, Traktati i fshehtë i Londrës i vitit 1913, i copëtoi trojet shqiptare midis shteteve ballkanike. Mbeti vetëm një copë truall të cilit iu dha pavarësia. Shqipëria e katër Vilajeteve u rrudh në vetëm 28 mijë kilometra katrorë nga Konferenca e Londrës.
Pas Luftës Çlirimtare të vitit 1999, fitoi lirinë pjesa më e madhe e Vilajetit të Kosovës. Megjithatë, të katër Vilajetet shqiptare, i kanë ende një pjesë të trojeve të tyre nën Malin e Zi, Serbinë, Maqedoninë

dhe Greqinë. Duke qenë nën trysninë e këtyre shteteve, popullsia shqiptare i përjeton pasojat në mënyrë dramatike. Në mungesë të shkollave shqipe, gjuha mëmë po shteret. Kjo sikur e ndrydh dhe e ligështon shpirtin e këtyre banorëve, por edhe shpirtin e poetit.
Po fatmirësisht, Shqipërisë së lirë një shekull më parë (1912), iu shtua dhe Kosova (1999), tashmë e lirë dhe e pavarur. Nëse përgjatë shekullit të kaluar, Shqipëria shihej si vatra rreth të cilit gjallonte identiteti kombëtar i shqiptarëve; tashmë kjo vatër është zgjeruar dhe me atë territor që quhet Kosovë. Në ditët e sotme, e tërë hapësira nga Mitrovica e gjer në Konispol, përbën vatrën e re rreth së cilës frymojnë shqiptarët që jetojnë jashtë këtyre territoreve. Poezia e Zapllushës është zgjatimi i Rilindjes Kombëtare në kohët moderne.
Se si do të quheshin territoret ku banonin shqiptarët e katër Vilajeteve, Poeti Kombëtar Naim Frashër i përjetësoi me vargjet lapidare: “Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqiptar”. Atëherë askush nuk dyshonte që territoret e banuara nga shqiptarët të mos përfshiheshin në atë shtet që do të quhej Shqipëri. Po nëse nga jashtë ishin fuqitë evropiane ato që kërkonin copëtimin e Shqipërisë për ta bërë dhuratë për fqinjët tanë, brenda vendit institucionet fetare në drejtim të të cilave ishin në shumicë përsëri të huajt, kërkonin që këto troje të copëtoheshin sipas vendeve nga kishin ardhur dhe që më shumë i përfaqësonin politikisht ato vende se

sa besimin fetar për të cilin gjendeshin në trojet tona. Atëherë, rilindësi tjetër i madh, Pashko Vasa lëshoi si kushtrim vargjet lapidare: “Feja e shqiptarit asht Shqiptaria”. Shqiptarët u grumbulluan rreth *profecisë* së Pashko Vasës, bashkim që ekziston i fortë dhe sot e kësaj dite.
Sot, pas më tepër se 100 vjetësh, shqiptarët ende trazohen nga duar misterioze. Ndonjë krahine duan t`i japin identitet të veçantë. Rilindësi i kohëve moderne, Adem Zaplluzha, ngrihet po aq madhërishëm sa paraardhësit e tij: “Jam shqiptar, s` jam çam as kosovar”. Dhe më tej, në vargje të mrekullueshëm shpaloset identiteti i shqiptarit:

“Unë kam vetëm një atdhe
Një flamur dykrenorë
Dhe më i pasuri në botë
Jam njeriu me tri fe”.

Dhe ky atdhe është ai që kërkonin Rilindësit dhe që u kurorëzua në Vlorën historike me ngritjen e flamurit kuq e zi nga të gjitha krahinat ku jetonin shqiptarët. Sot, bijtë e saj kudo që janë, njohin Shqipërinë e Ismail Qemalit dhe jo atë të Fuqive të Mëdha evropiane të vitit 1913. Të gjithë ata që u janë larguar idealeve të Rilindjes sonë Kombëtare, poeti Zaplluzha i portretizon kështu:
“Ata që mendojnë ndryshe
U ngjajnë kuajve të paçjerrë
Hingëllijnë nëpër fushëbeteja

Për qejfin e padronëve
Dhe lehin për të tjerë”.

3

Poezia**“Nesër do të këndojmë për atdheun”**, shpreh dashurinë njerëzore për atë truall në të cilin banojmë. Ndaj këtij trualli që quhet atdhe jemi të ndjeshëm edhe kur jetojmë brenda tij, edhe kur jetojmë jashtë tij. Gjithkujt i pëlqen hija e rëndë e rrapit në të gjitha format që i jep dita gjatë muajve të vitit, siç i pëlqen frymëmarrja e malit. Në këtë truall që quhet atdhe, lulet kanë tjetër aromë. Aty një gjethe peme sjell lumin e fëmijërisë. Një fije bari zgjon kujtesën ku një foshnjë rend pas fluturës në livadhin e blertë të pasdites. Në këtë heshtje të thellë, frymon dhe guri në lëndinë dhe, për ta rrokur gjithë këtë pasuri të bukurisë, qenia njerëzore kërkon të shndërrohet në zog. Megjithatë, qenia njerëzore kërkon të dalë përtej oazës së bukurisë dhe të qetësisë që të ofron natyra. Nuk jetojmë vetëm për vete. Jetojmë dhe për të tjerët. Për brezat që ikën dhe ata që do të vijnë. Nesër do të kemi shumë punë.

“Nesër do të këndojmë për atdheun
Këngët e pa kënduara me shekuj”.

Poezia për atdheun është bërë një temë e preferuar për autorin. Shqetësohet, por edhe gëzohet. Ia ndien gëzimin brezit të ri që rritet në

bedenat e atdheut, i madhërishëm e plot shpresë, ku shpirti ushqehet nga ëndrrat dhe realiteti i ri që u krijua pas Luftës Çlirimtare të Kosovës.

"Sa i bukur duket atdheu im dardan
Kur buzëqeshjet djaloshare
Si lulet pjalmojnë anë e mbanë**".*(Poezia "Sa i bukur duket atdheu im")***

Poeti tek poezia **" Ndonjëherë ngjajnë me drurët"** u kushton vëmendje dhe zogjve të vendit të vet. Si janë ata? Si flasin? Edhe ata janë pjesë e natyrës. Interesimi njerëzor duhet t`u drejtohet dhe atyre. Përse vallë nganjëherë janë të heshtur dhe nganjëherë janë të zhurmshëm? Po këta zogj ngjasojnë me fëmijët e varfër të Lumëbardhit. Nga sytë e tyre burojnë dritat e bardha të botës dhe detet e çmendur. Dhe kur shqetësohen dallgët: "Nga gjumi **i** Drinit të Bardhë
Zgjohen legjendat e fjetura
Zgjohen dhe u këndojnë serenata mëngjeseve".

Poezia e Zaplluzhës mban brenda zjarrin e dashurisë për atdheun. Ky vëllim poetik, tejet i arrirë artistikisht, na përcjell mesazhe të fuqishme për lirinë dhe krenarinë kombëtare, na ofron më shumë me njëri-tjetrin dhe na bën ta duam më shumë njeriun dhe shoqërinë ku bëjmë pjesë. Gjuha poetike është e ngrohtë dhe vargu i magjishëm.

Jehona e poezisë së tij i ka kapërcyer kufijtë e trojeve shqiptare. Kjo kërkon që të ketë më shumë vëmendje ndaj poetit, kurse institucionet shtetërore duhet t`i kushtojnë vëmendjen maksimale, sepse ky autor ia ka kushtuar jetën e tij artit dhe letërsisë dhe,nga ky përkushtim sakrifikues,është arritur një vlerë artistike me të cilën krenohet shoqëria shqiptare.

Trenat këtu gjithmonë vonohen

Cikli i parë

NGA SYTË E PLEPAVE

Thonë se ishte dimër
Dielli mbytej diku në horizont
Nga sytë e plepave
Si një lloj trishtimi
Pikonte dhembja e qiellit

Kush dënesi mbrëmë
Kur nga qerpikët e mjegullave
Shkundeshin trishtimet
Athua vallë
Nuk pat kush ta ndalte vajin

Nuk u ndalën as zërat e shirave
Si një kalama dëneste qielli
Retë e tunxhta
Pikonin mbi çatitë e rrënuara

Pikonin si loti i egër
Zëra fjalësh mbi përditshmërinë

Prishtinë,19 maj 2016

SI SYRI I XHAMTË I NJË PARAFJALE

Qenka herët
Shumë me herët
Se sa që mendojnë njerëzit
Ky shi i egër po bie me vrizma
Mbi mendimet e shthurura
Po ngjan me vdekjet e kashelashave

Askund asnjë hije e verdhë
Ky saç i diellit
Pa mëshirë po i zhurit
Flokët e thinjura të moteve
Paskan ikur edhe zogjtë e fëmijërisë

Ku t'i kërkoj duart e humbura

Kjo vdekje nuk i ngjan asgjëje
Duket kaq lakuriqe
E tejdukshme
Si syri i xhamtë e një parafjale

KËTU PASKAN VDEKUR FJALËT

Pas hapave të shpërdredhura
Mbetën disa fjalë
Pa sy dhe ndjenja të mirëfillta
Drurët lakuriq
I grumbullonin gjethet e fishkura

Një furtunë e padëgjuar
Mbrëmë shkeli mbi rrënjët e rrapit
Qielli sterrë me ngashërim
I përcillte retë e plumbta
I përcillte deri te varret vdekjet e drurëve

Asnjë zë nuk dëgjuam mbrëmë
Këlthitjet s’ kishin të ndalur
S’ndaleshin as piskamat
Foshnjat trishtoheshin
Nga një konvertim lakuriq

Askush më askujt nuk i beson

Këtu paskan vdekur fjalët
Vetëm një hije morbide
Parakalon nëpër vetminë e rrugicave
Parakalon si mbreti pas abdikimit

NË SYTË ROMBOIDE TË DITËS

Grunajat mbetën të pakorrura
Si një procesion eshtrash
Para syve të zgërlaqur
Parakalonte heshtja

Heshtnin edhe pemët
Kopshtet kokulur shikonin
Lindjen ose perëndimin e diellit
Në sytë romboide të ditës vdiste era

Më duket se qenkam shthurur
S'mund të dalloj kah i bie veriu
Dhe në cilën anë është jugu
Kjo frymë e verdhë po i ngjan harresës

Nuk di me se si të fle
Gjumi më paska ikur nga dhoma e fjetjes
Asnjë milingonë e kuqe
S'parakalonte si ushtarët e dylltë

KJO SHIJE E UJIT TË AKULLT

Nga buzëqeshja e jote e thartë
Qenkan shterur të gjitha krojet
Asnjë lumë më nuk buron
Nga sytë e kristaltë të fjalëve

Më duket se paskan vdekur
Edhe parathëniet e bozhureve
Luledielli për herë të parë
Po konvertohet në një tjetër lule

Zërat më s'dëgjohen nëpër rrugë
Heshtja e vdekur
Po i ngjan varrit të vithisur
Nëpër gryka lumenjsh vërshojnë milingonat

Kjo shije e ujit të akullt
Për herë të parë sivjet i hapi sytë
Po i hapin edhe drurët portat e shikimeve
Diku larg dëgjohej zëri kryengritës i malit

MBI SYPRINËN E DETIT TË SHTERUR

Ti sonte po ngjan
Me zërin e fishkur të barit
Në qenien tënde po rritet si uragan
Pema e pikëllimit të trishtuar

Asnjëherë s'je dukur kështu
Përse i shkunde pemët e stinëve
Ky diell i lodhur
I paska grisur të gjitha ëndrrat

Më duket se edhe njerëzit
Paskan mbetur pa asnjë ëndërr
Parakalojnë të vetmuar shëtitoreve
Ecin si kukullat e drunjta

Kjo rrugë e pafundme
S’paska të ndalur askund
Mbi syprinën e detit të shterur
Rrokullisje gurësh tatëpjetë e tërmal

ATË DITË BINTE NJË SHI I HIDHUR

Të lutem
Mbani sa më larg duart
Nga kjo dhembje
Dita paska ikur tej maleve

Nuk galopojnë më kuajt e egër
Nëpër luadhet e imagjinatës
Asnjë flutur e verdhë
S’ndalet më në kujtesën e lumit

Ku ishe ti kur s’binte pikë shiu
Në kujtesën e pemëve
Atë ditë fluturat i kyçën
Të gjitha llambat e pritjeve

Kurse ti si një oazë në shkretëtirë
I ledhatoje devetë e lodhura
Nga degët e kaktusit të vetmuar
Si rrëshirë binte një shi i hidhur

PËRPOS FRYMËMARRJES SIME

Mes kësaj heshtjeje
S'dëgjohet as zëzëllima e erës
Një borë e zezë pjalmon
Mbi flokët e thinjura të drurit

Gjethet s'marrin frymë
U ngjajnë peshqve të verbër
Një diell i zi në qiellin katran
Po i ngrinë fluturat e plagosura

Përpos frymëmarrjes sime
Dhe lopatës së varrtarit
Asnjë zë njeriu përreth
Këtu heshtja e paska vulosur kujtesën

Dimri i sivjetmë po i kafshon drurët
Nga shpirti i gjetheve
Trishtueshëm pikojnë ditët
Derdhen nëpër rrugë zërat e drurëve

I NGROHIN HIJET E MYKURA

Çdo gjë përreth nesh
Ka nga një kuptim alegorik
Ndonjëherë stilolapsat me duken
Si qirinj të ndezur funerali

Ndizen aq shumë sa që
I ngrohin hijet e mykura
Nëpër labirintet e heshtjes
Duken si pyka të ngulura në tru

Por gjithsesi janë stilolapsa
Me një bojë që ngjan
Rruazave të kuqe të mështeknës
Ngjan me djersët e milingonave

Ne herë i shikojmë të frikësuar
E herë ato na shikojnë neve
Por gjithsesi janë stilolapsa
Me ngjyrën e gjakut të amebës

TI DHE ËNDRRA E JOTE

Kur shikoj nga kjo perspektivë
Dukesh e madhe
Si parathënia e një alegorie
Nga flokët e tua të gështenjta
Derdhen shirat kosmogonike
Derdhen si nga shtambat prej zjarri

Në krahasim me ty
Dielli duket si një mollë e skuqur
Burimet e lumenjve në gjoksin tënd
I tejkalojnë
Të gjitha forcat e deteve
Kur çmenden bunacat

Ti dhe ëndrra e jote
Dy oqeane

Të një mendjeje të shthurur
Si dy sytë alegorike të dhembjes
Parakalojnë shëtitoreve
Duke u kalamendur si kardinalë të dehur

ATDHEU LAHEJ NË TRISHTIM

Ishte vjeshtë ose marsi i parë
Kur nga kraharori yt
Fluturuan pëllumbat e shpresës
Atdheu lahej në trishtim
Nga këngët e burrave qanin drurët

Më kujtohet ora e zezë e maleve
Mbi çatitë e shembura fluturuan dhembjet
Një plagë e paparë
Rritej në gjoksin e një lisi
Frika krahasohej me malin e djegur

Ne nuk i duruam dhembjet

Nga gjokset e drurëve i zgjuam baladat
Dhe këndduam si kurrë më parë
Këngët e harruara të patërshanave
Nga dizgjinët e kuajve fluturuan dykrenorët

NESËR DO TË KËNDOJMË PËR ATDHEUN

Për plagën dhe dhembjen time
Sa për sonte mjafton kjo tokë
Po më pëlqen pa masë hija e rënd e rrapit
Dhe frymëmarrja e malit

Lulet këtu paskan një tjetër aromë
Nga gjethet e pemëve
Si nga këngët e vjetra
Derdhen lumenjtë e fëmijërisë

Po ju them se më mjafton vetëm kjo heshtje
Dhe zëri i akorduar i barit
Në moçalin e kujtesës
Ende nuk më është zgjuar fëmijëria

Ju lutem pranoni si unë këtë heshtje
Shpirti i gurit në këtë lëndinë
Qenka aq i madh
Sa që po më hidhet të shndërrohem në zog

Për çudi më pëlqen kjo heshtje
Që i ngjanë uverturës së mëngjesit
Nesër do të këndojmë për atdheun
Këngët e pakënduara me shekuj

NDONJËHERË NGJAJNË ME DRURËT

Kurrë nuk kuptova
Se në cilën gjuhë flasin zogjtë e atdheut tim
Nganjëherë janë të heshtur
E nganjëherë të zhurmshëm
Por gjithsesi flasin si njerëzit

Ndonjëherë ngjajnë me drurët
Me vite të tëra
Jetojnë në heshtje
Jetojnë me shikime të mrrolura
Si fëmijët e varfër të Lumëbardhit

Në disa raste ekstreme
Duken si drurët
Nga sytë e tyre të gështenjtë
Burojnë detet e çmendur
Tok me dritat e bardha të dynjasë

Këto veprime më pëlqejnë

Sidomos kur shqetësohen dallgët
Nga gjumi e Drinit të Bardhë
Zgjohen legjendat e fjetura
Zgjohen dhe u këndojnë serenata mëngjeseve

SA HERË QË I MUROSËM DHEMBJET

Mbi këtë qiell fluturuan
Zogjtë e të gjitha llojeve
Më në fund
Lejlekët ia behën me arkivole pritjesh

Sa herë që i murosëm dhembjet
Nëpër qemrat e urave
Vendosëm nga një copë stralli të murrmë
Vendosëm djepin e gurtë
Që t'i dëgjojmë vajet e kërthinjve

Po nëpër ato ura
Kaluan zbythur kuajt me lafet
Dhe ushtarë të ikur
Nga betejat e dorëzuara
Gjeneral të dehur e kardinal pedofil

Kaluan edhe prostitutat

E të gjitha sojeve
Të lyera
E të ngjyera si kukullat e drunjta
Kaluan vdekjet e panumërta në heshtje

KURSE SHIU ALEGORIKË

Që nga kjo largësi e paprekshme
U bëjë zë gjyshërve legjendë
Asnjë zë njeriu në hapësirë
Era përtypet si kau i këputur në parmendë

Nga pllajat si ortek bore
Zbresin rrapëllimat e drurëve
Zbresin zërat
E mbytura nga dhembjet

Një nënë e moshuar
Përqafon bronzin e djersitur
Zëri troket në ndërgjegjen njerëzore
Troket si i çmendur në portat e mbyllura

Nëpër oborre shihen njerëz të dyshimta
Përmendoret dënesin në heshtje

Kurse shiu alegorikë
Troket nëpër ollukët e ndryshkur

Prishtinë, 20 maj 2016

I KYÇ LLAMBAT E NOSTALGJISË

Gjithmonë për njeriun mjafton një fjalë
Siç mjafton për fluturën
Ajri i pastër i mëngjesit
Mbi krahët e mjegullave të purpurta
Rendin zogjtë e vendlindjes

Sa herë që trokas në ndërgjegje
Një mall i pashuar
Ngjan me gacën e kujtesës
I kyç llambat e nostalgjisë
Dhe tërë kohën më ulet në prehër

Që nga larg e ndjej aromën e fjalës

Ndjejë mallin që s'di të shuhet
Ai zjarr prej legjende
Që digjet në mua brez pas brezi
Një ditë do kacafytet me sfinksin e kujtesës

FLUTURIMET E AVIONËVE PREJ LETRE

Sa herë që zbres nga shkallët e metaforave
Në fund të ecjes
Më presin me qindra zogj
Duke i përshëndetur fluturat e nostalgjisë

Atë çast përpos etjes
S'dëgjohet as zëzëllima e krahëve të bletës
Një zog prej imagjinate
Fluturon hapësirave blu

Njerëzit duken si drurët
Heshtin kur nuk duhet
Dhe flasin mu atëherë
Kur më së paku kanë nevojë

Nën gjethet e fishkura
I zgjojnë larvat e kandrave
Dielli i uritur shikon me nostalgji
Fluturimet e avionëve prej letre

TRENAT KËTU GJITHMON VONOHEN

Kam mbetur pa asnjë iluzion
Në kokën time të dërmuar
Vetëm heshtja e bronztë
Pandërprerë llamburit
Llamburit me lopatat e thyera të trishtimit

Kjo vjeshtë ose ky dimër
Sivjet për herë të parë
Kthehen me kaq vonesë
Sa që më duket se të gjitha stinët
I kanë çakorduar oraret e ardhjeve

Ju thashë se te ne
Kurrë nuk është pranverë
Trenat këtu gjithmonë vonohen
Edhe kur ndalen në qytetin e ëndrrave
Duken se u mungojnë itineraret

Vetëm binarët e ndjejnë mungesën

E fërshëllimës së përgjumur
Sa herë që ndalen trenat për të pirë ujë
Me javë të tërë
Në qytetin tim nuk bie shi

POR GJITHSESI ISHTE LULE

Sa here që ledhatoja një lule
Ndjeja se si shpirti i saj
I kishte njëqind ngjyra

Një ditëi ngjante ylberit
Kurse ditën tjetër
Ajo i adhuronte saksitë

Ishte prej atyre luleve
Që aromën e huazonte prej gjelbërimit
Dhe këndonte kur ishte pranverë

Në dimër qante me kallkanët
Edhe ullukëve ua mbante ison
Kur vajtonin si qyqet

Thoshte se gjithmonë dimri
I dukej një ëndërr e bardhë
I donte pemët vetëm kur lulëzonin

Kishte një pamje të përkryer
U ngjante kristaleve të kripës
Por gjithsesi ishte lule

AS NUK DINË TË UDHËTOJNË

Nëpër shëtitore
Takoj njerëz pa itinerar në kokë
Shikojnë nëpër zbrazëtit e drurëve
Pa kurrfarë ideje
Ecin deri te e panjohura

Ecin shtigjeve të pakapërcyeshëm
Nuk e njohin vetveten
As nuk dinë të udhëtojnë
Nën hapat e tyre mbin kërpudhat
Gjumin e bëjnë nën urat e qyteteve

Më duket se janë gjallesa pa nocion
Si të vdekurit i prekin hijet
Kur i humbin rrugët
Nuk i ngjajnë më as njeriut
Urinojnë nëpër shkurre të thata

Mes gishtave skelet

I fshehin çelësat e mjegullave
Dhe sa herë që dëshirojnë shndërrohen në shi
Herë bien në tokë
E herë mes mjegullave i spërkasin lakuriqët

E HERË NGA PALCA E TOKËS

Mes pemishteve të dendura
Rrjedhin lumenjtë
Rrjedhin metaforat e fjalëve
Kjo alegori e dhembjes
Nuk paska se si të shërohet sivjet

I hapëm porta e mbyllura
Por lejlekët nuk na erdhën
Sivjet dimri
Nuk i ngjante asnjë dimri
Nga kallkanët pikonte vera e kuqe

Kurse lumenjtë nuk dinë të ndalen

Përbirohen nëpër gishtat e erës
Ngjajnë me urithin
Herë burojnë nga shkëmbi i stralltë
E herë nga palce e tokës

I NGJANË LULEVE TË VERDHA NË VJESHTË

Sot është dita e parë e pranverës
Por gjethet po bien si në vjeshtë
Po bien edhe besëtytnitë
Si perënditë paganë po bien shirat

Asgjë më nuk është siç ishte dje
Edhe kjo borë e kuqe
Për çudi e paska ndryshuar ngjyrën
I ngjanë luleve të verdha në vjeshtë

Nuk është hera e parë sivjet
Që po bie ky shi i çmendur
Çdo gjë në këtë kohë
Përjeton metamorfozën e bretkosës

Pemët janë zhveshur si nuset
Po e përcjellin modën e fundit
Këto pamje alegorike
Po mi përkujtojnë portat e Ferrit

Një hënë gjysmë nudo
Si foshnja po lahet në një vaskë druri
Sa shumë xhelozojnë sonte yjet
Për këto pamje fantazmagorike

IKËN EDHE QYQET NGA KY SHKRETIM

Në këtë qytet fantazmë
Nuk më njeh askush
As unë nuk i njohë pemët
Vetëm kanjushat e verdha
Kohë pas kohe fluturojnë mes degëve

Një harabel dhe një kukuvajkë
Mbrëmë i ndërruan çerdhet
Ikën edhe qyqet nga ky shkretim
Asnjë njeri nuk mbeti
Pranë mureve të rrënuar të kalasë

Vetëm hijet morbide
Si një ushtri skeletesh të murrmë
Shëtisin shëtitoreve të zbrazëta
E kukullat e dyllta
U këndojnë serenata zogjve të verbër

Askush përpos meje nuk piu ujë në shatërvan

Vetëm duart delikate të mbathtarëve
I mbathën për herë të fundit
Kuajt e bardhë të luftës
Sa që hingëllimat udëgjuan tej atyre maleve

PRANË NJË BUSTI PREJ BRONZI

Si këndesat e egër mbi platformën e gjuhës
Kërcejnë fjalët
Njerëzit dalin rrugëve lakuriq
Po ashtu edhe mjegullat
Vërtiten bulevardeve pa itinerar

Pranë një busti prej bronzi
Egërsisht puthen dy të rinj
Flokët e shprishura të shirave
Kolliten si drurët në mal
E gjethet si nëpër përralla veniten

Fishket edhe njomësia e barit
Një lehje e pakontrolluar
Dëgjohet përtej një porte të kyçur
Fëmijët barkcullak
Me hapa të shkujdesur kalojnë përtej gjolit

Ky dimër i sivjetshëm

Po na i thanë të gjitha pjergullat
Për pranverën e ardhshme
S'do mbetet asnjë njeri
Të na pjekë një gotë raki në shpirtin e stinës
NJË ZË PREJ BARRITONI

Mbrëmë fluturua kanjushat e verdha
Nuk kishte mbërri as vjeshta
Asnjë pullë postare
S'kishte mbetur nëpër kinkaleritë e qytetit

Një qetësi mortore zëzëllonte në ajër
Vetëm zëri i barit të fishkur
Më duket se dëgjohej në largësi
Dëgjohej si një muzikë e lashtë

Asnjë pëllumb nuk fluturoi
Mbi oxhakun e vetmuar të një çatie
Vetëm korbave u dëgjoheshin krakëllimat
As kambana s'ishte në gjendje më të mirë

Më duket se atë çast
U takova me vdekjen e gjelbërimit
Përroi i zanave si kurrë më parë
Dëgjohej lugut duke vajtuar

Dënesnin edhe drurët nëpër male
Një zë prej baritoni

Për herë të fundit gjëmoi si Drini i Bardhë
Fusha e mëllenjave dëneste si qilimi

Prishtinë, 21 maj 2016

Secili trembet nga hija e vet

Cikli i dytë

ASNJË NJERI NUK QANTE

Ne të gjithë u stepëm
Kur pamë se si një vashësy qielli
I përshëndete mjegullat
Dhe lejlekët duke ikur nga atdheu

Ishte ora shtatë dhe shtatë herë
Retë ndryshuan itinerarin
Binte një shi imcak atë ditë
Binte pa ndërprerë mbi flokët e trishtimit

Shikonim barin që rritej
Rritej si dhembja jonë e pashëruar
Një mace e zezë katran
Askujt atë ditë nuk ja preu rrugën

I thirrëm të reshurat
Gurtë dhe drurët e malit
Thirrëm çdo gjë që mund të thirrej
Thirrmat tona ngjanin britmave Othelliane

Dikur vonë doli në shesh
Heshtja e pllakosur
Asnjë njeri nuk qante
Ishin gurëzuar drurët dhe gurtë

I ZGJASIN DUART E PASHPRESË

Nëpër rrugë dhe lagje shoh fytyra
Të mavijosura dhe të lodhura
Njerëz me nga një breng në shpirt
Që shkasin
Shkasin si kallinjtë e shkundur
Nëpër kujtesën e thasëve

I shoh nënat me nga një mallkim në shpirt
Dhe djep të vjetër
Ndoshta janë djepat e gjyshërve
Ku akoma dëgjohen britmat
Nga pjesët e dërrasave të mykura
Dëgjohen këlthitje e mureve të lagshta

Dëgjohen si një monotoni e padëgjuar
Zërat e përvajshëm të foshnjave

Dhe kurrë nuk kuptuam
Vajin e tyre alegorik
Athua vallë qanin fatin e pafat
Të atdheut të dhunuar e të plaçkitur

2.

E njoh atë djep o fare mirë e di
Nga cili dru është gdhendur
Dhembja e ditës
Shoh se si vajtojnë gjethet e mykura
Vajtojnë
Fatin e brishtë të një kohe

Nëpër rrugë sërish shoh
Njerëz dhe këpucë pa sholla
Lypsarë të të gjitha moshave
Shoh se si i zgjasin
Duart e pashpresë
I zgjasin
Në drejtim të një shprese imagjinare

MBASE QENKAN SHKUNDUR STINËT

Udhëtova njëqind vjet dhe shpresova
Se do të takohemi një ditë
Askund asnjë lehje qensh
Nuk dëgjova nëpër sinorët e atdheut

Më duket se kishin vdekur drurët
Bari i fishkur nuk merrte frymë
Një bretkosë e gjelbër
Bisedonte me rrapin kryeneç

Ishte udha e gjatë deri te etja
Kalova me mija kilometra
Nëpër rrugët e leckosura
Nuk takova asnjë pemë me fryte

Mbase qenkan shkundur stinët
Zogjtë klandestin nuk erdhën në atdhe
Kurse ne besuam se rritja e barit
Nuk ishte rastësi por një ëndërr

SA HERË QË KISHIM URI

Asnjëherë nuk erdhën shirat
Drapri i kujtesës
Kishte mbetur jashtë hapësirës
Hëna korrte ëndrrën e gjelbërimit

Kështu ngjante përherë
Kur vonoheshin stinët
Ne nuk dinim se kur fillonte pranvera
E kur përfundonte dimri

Më duket se na mësuan të heshtim
Heshte edhe gjelbërimi
Kosa e fjalëve
Ishte fshehur mes luadheve të imagjinatës

Kurrë nuk besuam edhe sot s'besojmë
Se dielli i ngjan patates së skuqur
Prandaj sa herë që kishim uri
Kafshonim trungun e akacies

SËRISH DIMRI SI BISHA E EGËR

Sonte kam shumë të ftohtë
Nuk është dimër
Kurse dimri i egër
Paska lëshuar thellë rrënjët mes kallkanëve

Pohuan se lufta nuk ha petulla
Por njeriu sa shumë ka nevojë
Për një petull të mykur
Saqë të gjitha luftërat i gjuan pas shpine

Sërish dimri si bisha e egër
Afrohet me putrat e akullta
Që nga larg dëgjohen zërat e petullave
Kur era i skuq në fultere mollët e verdha

Dimri lufta dhe petullat
Dita e skuqur fërgohet në diell
Kurse dielli për mrekulli piqet
Si qershitë në degët e përhitura të mjegullave

PËR BESË NGA KY TOG ME BALTË

Më duket se nga ky togë baltë
Nëna ime gatuante bukën më të madhe
E tërë lagja qenka grumbulluar sot
Në sofrën e zezë të mjerimit

Po ashtu rrapi kryeneç qenka në vendin e vet
Nuk paska lëvizur asnjë centimetër
Sa herë që afrohet vjeshta
Nuk i shkund gjethet më larg se dy pashë

Sot qenka zgjuar nostalgjia e fjetur
Dhe po i lyen muret e kujtesës
Shikon rrapin dhe njerëz të ekzaltuar
Dasmat këtu zgjasin me muaj

Për besë nga ky tog baltë
Nëna ime gatuante bukën më të madhe
Sa që shtat fshatra
Mund të hanin më shumë se shtatë vjet

MË DUKEN SI KOLONADAT ANTIKE

Këtu në qytetin tim
Nën këto çati të rrënuara
Flenë zogjtë prej balte
Flenë edhe merimangat e pemëve

Shiu i pranverës gjithmonë
Zbret nga qielli i mërrolur
Zbret ashtu hije rënd
Si ndonjë kardinal i hidhëruar

Muret e lashta të qytetit
Më duken si kolonadat antike
Ngjajnë me sfinksat e shkretëtirës
Me kryeneçësi shikojnë shembjet e dunave

Ndonjëherë bie shiu imcak
Drurët dhe njerëzit
Dalin rrugëve duke shikuar qiellin
Që asnjë armiku askurrë nuk u dorëzua

SHIKONTE PARA VETES DETIN E VARFËRISË

Ajo kishte një gojë të vogël
E sy të mëdhenj
Hante pak se s'kishte çfarë të kafshojë
Dhe me sy prej biluri
Shikonte para vetes detin e varfërisë

Shikonte edhe anën tjetër
Të medaljes
Një bollëk i pangopur në sytë e fqinjëve
Nëpër oborrin prej përralle
Loznin qentë me lodra kristali

Ajo vetëm shikonte dhe përmallohej
Nënën e kishte përcjellë te yjet
Kurse të atin shtatlartë
Hirin e të cilit me gishtat e saja të holla
I prekte në ajrin e tymosur të mëngjesit

Ajo kishte një gojë të vogël
E sy të mëdha si deti
Por dashurinë që e mbante në shpirt
Ishte aq e madhe
Sa që s'vendoset në asnjë hapësirë

KUJTIMET JANË AQ TË FRESKËTA

Mbrëmë si nëpër akull të kristaltë
Yjet shkisnin mbi gjoksin e hapësirës sterrë
Po ashtu shkisnin edhe kujtimet
Si nga ndonjë ëndërr e bukur
Zgjohet dhe i hap sytë nostalgjia

Sa herë që shoh grumbuj yjesh
Më kujtohen kuajt e fëmijërisë
Më kujtohet vrapi i tyre metaforikë
Mbi syprina reshë të bardha
Galopojnë kujtimet e zgjuara

Ja këtu mu nën këtë pemë të shenjtë
Për herë të parë
I putha sytë e kaltër të hënës
Çastet e asaj dite janë aq të freskëta
Sa që po më duket se jam ende duke puthur

Vrapojnë me një galop të paparë
Minutat e paharruara që tani më
Janë shndërruar në përmendore
Pjalmi i dëborës së pleqërisë
Për herë të parë po mi ledhaton ndjenjat

TË VEGJLIT

Nga skamja
Të vegjlit duken edhe më të vegjël
Me buzë dhe sy të fishkur
Kalojnë pranë nesh
Etjen e kanë aq të madhe
Sa që asnjë det
S'mund të mbushet me të

Të vegjlit ecin pa këpucë
Dhe sandale të kuqe
Lëkura e tyre e regjur
Gjithmonë ngjanë
Me këmbët e breshkës së shkretëtirës
Kur i përtypin degët e kaktuseve
Nga gjuha e tyre pikon trishtimi

Të vegjlit nganjëherë janë
Aq glorifikues
Sa që nga shpirtrat e tyre
Burojnë të gjitha lumenjtë e botës
Më duket se
Ata janë sa të lumtur
Po aq edhe krenar me skamjen e tyre

SECILI TREMBET NGA HIJA E VET

Njerëzit e lagjes sime tremben
Tremben për çdo ditë
Si zogjtë e lagur në shi frikësohen
Të mos bankrotojnë dyqanxhinjtë

Kështu është jeta në këtë mjedis
Secili trembet nga hija e vet
Kur i shohin macet e zeza
Me bastunët e gjyshërve i rrahin rrugët

Nëpër secilën çati të vjetër
I fshehin ëndrrat e mira
Ato të trishtuara
Druajnë të ua tregojnë të tjerëve

Kështu njerëzit e kësaj lagjeje
Jetojnë prej një frike në tjetrën
Nga drurët huazojnë guximin
Për të dalë sa më shpejtë në pranverë

UNË S'JAM ÇAM AS KOSOVAR

Ju përgjëroj njerëz mos më mashtroni
Unë kam vetëm një atdhe
Një flamur dykrenorë
Dhe më i pasuri në botë
Jam njeriu me tri fe

Ata që mendojnë ndryshe
U ngjajnë kuajve të paçjerrë
Hingëllojnë nëpër fushëbeteja
Për qejfin e padronëve
Si qentë e zgjebosur lehin për të tjerë

O ju lutem mos më mashtroni
Ju thashë se jam shqiptarë
Kam vetëm një atdhe
Një flamur dhe një varr
Mbi këtë dhe me tri fe

Unë s'jam çam as kosovar
Në dreq të mallkuar
Kjo e keqe vaftë
Kurrë s'do të lejoj të mos jem shqiptar
He Zoti i madh ju vraftë

PALLTOJA IME E VJETËR

Sot do të bëjmë çmos
Për të mbërri deri te portat e hapura
Palltoja ime e vjetur
Veç ka filluar të tulatet si pinguini
Mezi rri mbi shpatullat e mija
Po ashtu edhe kravata më është zgjatuar

Më janë rritur tej mase pantallonat
Që i pata hekuros para lufte
Mbase s'kisha asnjë rast ato ditë
Që t'i përdori
Pas lufte dimrat ishin të padurueshëm
Nuk kishim as dru për ngrohje

Disa ditë me radhë
I përdorëm orenditë e vjetër
Më pastaj na ngrohte rrogozi
Zvogëloheshim ne e rritej acari
Dritaret i mbyllnim me gazeta
Na dukeshin më të ngrohta në errësirë

Për befasinë e të gjithëve
Asnjëherë nuk e ëndërruam pranverën
Ndoshta heshtja e jonë e përgjumur
Ishte tepër domethënëse
Por as nuk kishim me kë të bisedojmë
Sepse fqinjët tanë i përpiu lufta

I DËGJONIM EDHE BRITMAT E PLUMBAVE

Ajo katrahurë e atyre ditëve
Përfundimisht desh na çmendi
Si arinjtë flinin qytetet
Ishte numri i vogël
I atyre familjeve
Që përgatisnin djemtë për luftë

Nuk kishte kurrfarë organizimi
Nëpër oda me dritare të errësuara
Patriotizmi valonte si qumështi në kusi
Kurse në anën tjetër
Nën kajsishtat e mbjella
Armiku i dhunonte edhe pemët e shkulura

Mbi qiellin e zi
Për çdo ditë
Fluturonin zogjtë e hekurt
I dëgjonim edhe britmat e plumbave
Por ec e qite kokën në rrugë
Kur në pragun e derës të prite mortja

Prishtinë, 22 maj 2016

MBI KËTO BEDENA TË ATDHEUT

Këto janë imazhet
Më të bukura sot për sot
Mbi këto bedena të atdheut
Ndjehem i madhërishëm o Zot

Nëpër fushat e gjëra dhe të paanë
Si kaprojtë e egër fëmijët vrapojnë
Çfarë kënaqësie tjetër
Në këto çaste mund të ëndërrojmë

SA I BUKUR DUKET ATDHEU IM DARDAN

Atdheu i jonë krenar
Si një zog gjigantfluturon mbi qiell
Retë sogjetarë
I këndojnë serenata lirisë
Ku orë e çast
Një diell i madh shpirtin na miklon

Ëndrrat e djemurisë
Si kurrë më parë galdohen
Nëpër bozhure valle fluturash
Sa i bukur duket atdheuim dardan
Kur buzëqeshjet djaloshare
Si lulet pjalmojnë anë e mbanë

ÇELIN ME QINDRA ZOGJ TË RINJ

Nuk trokasim më nëpër porta
Ato janë gjithmonë të hapura
Një muzikë kozmike
Dëgjohet përbrenda mureve

Për çdo ditë këtu lind një Diell i Ri
Kur vijnë mbrëmjet
Nën pemët e lulëzuara
Njerëzit përherë dashurojnë

Burimet janë të kristalta
Ngjajnë me shpirtin fluidtë lagjes sime
Kavakët asnjëherë më
Nuk e ndalin rritën e degëve

Kur bien shirat me vrizma ylberesh
Netëve nën hënë
Shpendët krenarëtë atdheut
Çelin me qindra zogj të rinj

KOHA E HUMBUR SOROLLATET

Kur më zë vetmia
Fundosem në shpirtin tim
Dhe si një zhytës profesional
Notoj si i çmendur notoj
Nëpër detin e kujtimeve

Ju thashë
Kur më zë vetmia
Nuk i ngjaj asnjë njeriu
Nuk di sa është ora në qytet
Kjo e shtëpisë qenka ndalur sot

I pyeta edhe fqinjët
Por as ora e tyre s'punon
Qenkan ndalur koha në këtë lagje
Fjala e humbur sorollatet
Nëpër degët e thyera të gështenjave

SI NË NDONJË FUNERAL I NDEZI QIRINJTË

Sa herë që hapen dritaret
Dielli si hajdut
Futet në dhomë pas meje
Ulet në kanape
Dhe ligjëron me zërin e tij kozmik

Si në ndonjë funeral mbretëror
I ndezi qirinjtë
Bëhem sy e vesh
Dëgjoj deklamimin e poemës së mjerimit
Dëgjoj zërin e trishtuar të historisë

Dhe sërish një zë nga hapësira
Me hapa të bronztë
Shkel mbi shqisat e mia
Për çudi asgjë më nuk dëgjoj
Vetëm vetmia ime kalamendet mes mureve

SËRISH NJË PREKJE E AKULLT

Qëndroja ulur mbi një gurë
Dhe i ndjeva mbi supe prekjet
E flokëve të saja
Ishte verë ndoshta edhe vjeshtë
Ngjaja me trungun që s'bëzante

Kaloi edhe një kohë e gjatë
I shikoja kanjushat kah largoheshin
Hapësira më dukej e zbrazët
Nën çatinë e mbuluar me kashtë
Dritaret hapeshin vetëm në pranverë

Sërish një prekje e akullt
Ndjeva mbi supin tim të djathtë
Athua vallë më preki era
Ose flokët e saja ende paskan mbetur peng
Mbi degët e thyera të manit

Mbrëmja ishte ulur në kanape
Dhe me një bastun prej shimshiri
Shkruante emrin e saj në ajër
Shkruante një lloj inicialesh
Që kurrë askush nuk i kuptoi

POR GJITHSESI ISHTE DIMËR

Nuk ka mbetur shumë
Nesër do ta kalojmë errësirën
Ky tunel i fundit
I ka vetëm dy dalje

Thashë se nesër do ta kapërcejmë
Përfundimisht rubikonin
Do i përpijmë të gjitha lumenjtë
Do i përpijmë derisa ngopet etje

Më pastaj në fund të rrugës
Na presin befasitë
Po që se mbërrimë me kohë
Do i vjelim pjergullat e pjekura

Atë ditë nuk pjalmonte asnjë fije bore
Por gjithsesi ishte dimër
Kjo stinë e vjeshtës
Asnjëherë nuk i ngjan vetvetes

PËRPOS NJË NËNE TË MOSHUAR

Mbi qytetin tim i shoh gjërat e dëshpëruara
I shoh që rrinë në heshtje
Askush nuk ua trazon gjumin
As lojën mes dy zjarreve
E cila luhet me qindra vjet në lagjen tonë

Këtu njerëzit jetojnë në heshtje
U ngjajnë mureve antike
Sa herë që rrënohen në kujtesë
Të nesërmen shoh se si nëpër të çarat
Zvarriten grumbuj glistrash të konvertuar

Pakëz më tutje te shatërvani
Ose te shëtitorja
I shoh statujat e bronzta e të vetmuara
Thua se janë të dënuara prej kalimtarëve
Asnjëri nuk vëren shqetësimin e metaltë

Ndoshta as që dëshiron dikush t'i vërej
Përpos një nëne të moshuar
E cila çdo ditë herët në mëngjes
I pastron glasat e egra të shikimeve
I pastron me lotin dhe dhembjen e saj

NGJAN ME RULETIN RUS

Në secilin xhep i kam
Nga dy lloj zaresh
Sa herë që i gjuaj mbi tavolinë
Këlthas si i çmenduri i Sirakuzës

Kjo lojë e lashtë në disa raste
Ngjan me ruletin rus
Mund të të tradhtoj shpirti
Pa asnjë krismë në ajër

Kurse të gjashtë këndet e zareve
Shtatë herë këlthasin
Sa që britmat çuditërisht ngjajnë
Me ato piskama të Othellos

Kur netët bien në gjumë
E britmat fashiten mbi syprinën e mjegullave
Atëherë zaret prej eshtrave
Lozin vallen e trishtuar të errësirës

DHOMA E MADHE MA ZË FRYMËN

Nuk mund t'i krahasoj me asgjë
Rrugët e qyteti tim
Dikur kam menduar se ngjajnë
Me kopshtet e mollëve
Ose me bishtat e këputur të turtujve

Kur mbrëmjet i dorëzohen qetësisë
Zhurmët monotone
Kalojnë nëpër ingranazhetendryshkura
Të shpirtit tim
Një pjesë e natës kollitet në korridor

Unë vetëm shikoj me nostalgji
Nuk ka se kush të më ndihmoj
Dhoma e madhe ma zë frymën
Kurse dera e jashtme
Rrapëllon nëpër muret e mykura

KURSE TANGOJA E JONË SAPO KA FILLUAR

Përtej atyre shkurreve të thata
Është një tjetër tregim
Atje luftohet për jetë a vdekje
Kurse këtu një violinë e vjetër
Vajton si foshnja e uritur

Ndoshta sonte do të vallëzojmë
Tangon tonë mortore
Është hera e fundit që po shihemi
Shiko sa bukur i kam lyer këpucët
Nesër na pret një rrugë e gjatë

Para pak çasteve disa plumba
Fluturuan deri këtu
Atje po luftohet
Thikat e ndryshkura ngulen në asht
Kurse tangoja e trishtimit sapo ka filluar

PËRROI KËNDON NJË KËNGË TË LASHTË

Kur i shikojmë fluturimet e zogjve
Nëpër degët e nerenxës
Na duken ato flatra
Si lojërat tona arkaike
Njëri me këmbë të drunjtë në lagjen tonë
Çdo ditë i shuton topat prej lecke

Tjetri me gishtat e tij skelet
Për bukuri luan një melodi
Në një fyell të drunjtë
Përroi këndon një këngë të lashtë
Të cilën e njeh vetëm kavalli i metaltë
Era i ndërron perdet e tingujve

Kështu për çdo ditë e në çdo kohë
I ndërrojmë vendet e parathënieve
Kur nuk kemi se çfarë të bëjmë
Ecim si përherë këmbëzbathur
Ecim nëpër monopatet
E kujtesës së fëmijërisë së harruar

Prishtinë, 23 maj 2016

Ne gjithmonë vuajmë
Cikli i tretë

SA HERË QË SHKUAM NËPËR VARRE

Nuk është hera e parë
Kur pamë nëpër fusha të djegura
Kafka njerëzish
Mermer të kuq dhe trëndafila të zinj

I dëgjuam edhe hingëllimat e mjegullave
Kuaj të cofur në gjoksin e atdheut
I cili më nuk i përngjante asgjëje
Përpos një kungulli të kalbur

Ende pa u pjekur i shkundëm qershitë
Nga rrënjët mësuam alfabetin e Morzeut
Dhe ishim të lumtur
Kur kuptuam se si duhet të këndohet himni

Sa herë që shkuam nëpër varre
Mbollëm nga një copë druri të akacies
Duke besuar se në lulet e saja
Bleta e harron gjysmën e mjaltit të mbledhur

E KAPËRCYEM TË PAMUNDURËN

Nga një dhunë e paparë
Nënat tona të mira
Mësuan ta sajojnë guximin
Kur i shtrimë duart përtej fjalëve
Atdheu na mësoi artin e qëndresës

Filluam t'u ngjajmë rrapeve
Sa herë që na kanosej etje
Krijonim krojet nga rrënjët e drurëve
Dhe mësuam fare mirë
Se si ta mashtrojmë urinë me këngë

Kur kishim të ftohtë prej ashklave
Të drurëve shumëvjeçar
Ndërtonim anije kozmike
Sa që kur paraqitej acari
Dielli i ngrohte eshtrat e dërmuar

Kaluan vitet por edhe shekujt
Kurse ne si gjithmonë
Ishim të durueshëm
kapërcyem të pamundurën
Për t'i dal Zot atdheut të përvuajtur

NE I SHKUNDËM PEMËT ATË DITË

Më duket se ishte koha e fundit
Që ai të kthehet
Por ngjau e kundërta
Iku për të mos u kthyer asnjëherë

Më kujtohet kur pranë portave e lë trastën
Futi një kafshatë bukë në xhep
Dhe nën pallton e vjetër
Njëherë e përgjithmonë e harroi fëmijërinë

Ne i shkundëm pemët atë ditë
Që të kemi se çfarë të thajmë për dimër
Por ia behën krimbat dhe na qitën fare
Atë vjet u mësuam ta ziejmë gurin

Mësuam aq mirë
Sa që e zhveshëm deri në asht malin
Po ashtu mësuam të durojmë
Që të na teproj buka deri në pranverë

OSE ÇDO GJË ISHTE

Tufa zogjsh të egër
Me krah e rrahin qiellin
Iknin përtej reve
Deri në moskthim

Mbase vallë mos patën
Takim me diellin
Ose çdo gjë më dukej në rini
Si një i largëti vegim

KUR NË FUND TË RRUGËS

Si somnambul eca
S'u ndala kurrë
Nëpër botë udhëtova
Kudo pashë njerëz ngarkuar me ëndrra

Nëpër shtigje dhembjesh
Si i çmendur kalova
Dynjaja si gogël më dukej fare
Embeta udhëve pa shpresë e zhgjëndrra

Në një zbrazëti të pafundme
I stivova mendimet
Një pendël harabeli
Përpara më doli

Si ëndrra e Sizifit
Mu shfaqën hidhërimet
Kur në fund të rrugës
Më prite trishtueshëm gjoli

MES LIBRAVE JETOJ SI KRISHTI ME KRYQIN

Unë nuk i ftoj në duel
Retë e hirta e as mjegullat
Nga natyra s'jam Don Kishot
I shartoj hardhitë kudo nëpër vreshta
Punës time fare mirë i dal zot

Për çdo mbrëmje në kanape
Ëndërroj dhe shkruaj poezi
Muzën e kam mike për jetë e mot
Si kristale bore pjalmojnë vargjet
Kështu siç ndodh edhe sot

Mes librave jetoj si Krishti me kryqin
Mëngjeseve herët bisedoj me barin
Në pyllin më të afërm mu si bleta
Nga brirët e kaprojve
Magjishëm pjalmoj me beharin

LARASKAT E TË GJITHA LLOJEVE

Më kujtohet kur qanim si zogjtë
Qielli ishte i ngrysur
Vetëm avionët prej trishtimi
Fluturonin mbi kokat tona

Fluturonin edhe korbat
Laraskat e të gjitha llojeve
Krakëllimat e çafkave
Na i shurdhonin shqisat e të dëgjuarit

Tregojnë pleqtë
Për dimrat e zi në malet tona
As arinjtë e Sharrit
Nuk e duronin dot acarin që i çante drurët

Vetëm rrënjët e rrapeve
Disi qëndronin krenar si shkëmbinjtë
Dhelprat strukeshin nëpër vërrima
Për t'i shpëtuar ngricës së lumenjve

ASHTU SIÇ NUK MË PËLQEJNË AS MURET

Mbrëmë i theva të gjitha pasqyrat
S'dua të jem në brendinë e asnjërës
Sa herë që i shikoj
Më zihet fryma deri në alivanosje

Nuk i dua pasqyrat e varura
Ashtu siç nuk më pëlqejnë as muret
Në secilën sosh
Mund ta preki me sy të kaluarën

Nuk dua asgjë që ma përkujton
Fëmijërinë time të vjedhur
Kazanin prej bakri
Ku nëna ziente gurë për drekë e darkë

Po ju them nuk i dua pasqyrat
Sikurse muret që më ngufasin
Asgjë nuk më pëlqen
Që vjen pas meje si zvarranik

TOK ME SHPIRTIN TIM ENDACAK

Më duket se me qindra vjet
Këpucët e mia
Tok me shpirtin tim endacak
U ngjajnë potkonjve të kuajve

Kur pinë ujë zanat
Në shuplakat e latuara të vetëtimave
Dizgjinët më duken si djemtë
E përçudnuar të mëgojëzave

Sa herë që e shalova erën
Ngashpirti im rebel u zgjuan
Kalorësit e çmendur të Apokalipsit
U zgjuan për t'i kalëruar retë e bardha

Ju thashë njëherë
Se aq shumë i dua kuajt dhe pasqyrat
Sa që jam në gjendje
Të shndërrohem në sfinks prej mjegulle

Nuk keni se pse të befasoheni
Bisedoni njëherë me kalin
Vetëm atëherë do të kuptoni
Se sa mirë e njeh gjuhën e njeriut

NE GJITHMONË VUAJMË

Ne vuajmë gjithmonë
Kur kemi diçka tepër në shpirt
Ajo barë e rëndë i tejkalon
Të gjitha mundësit tona

Po ashtu dhe dashuria si hidhërimi
E kanë të njëjtën peshë
Sa që qemerët e kujtesës
Nuk janë në gjendje ta bartin

Ne gjithmonë vuajmë
Nga e njëjta sëmundje
I shtrimë duart përtej shikimeve
Për të mbetur gjithmonë më afër dhembjes

HERË LINDIN NGA FJALA

Nëpër kalldrëme kalojnë vashat syullinj
Me pamje delikate
Ecin deri në asgjësim të ditës
Sillen shëtitoreve si fluturat përreth zjarrit

Në hapin e secilës sutë
Lind nga një tregim fantazmagorik
Vashat mendje deti
Parakalojnë me shpirt të ankoruar

Secila prej tyre kanë nga dy ëndrra
Njërën për sot kurse tjetrën për nesër
Me duar prej mjegulle
Përqafojnë pjalmimin e stuhive

Vashat sybajame të qytetit tim
Herë lindin nga fjala
E herë depërtojnë nga mjegullat
Për t'u lindur mbi dallgët e një copë shkume

KU ISHIT JU

Ku ishit ju
Kur në tokën tonë
Dhe në barkun e nënave
I dëgjuam piskamat e fëmijëve

Ato ditë si qilimit
Dëneste Fusha e Mëllenjave
Kurse ju deheshit
Si gomarët në diell

Në ju pritëm te portat e lirisë
Ju pritëm
Si Krishtin e Ri
Ju erdhët
Kur u lëshuan perdet e trishtimit

Shpirti i jonë trishtohej në teatrin antik
Skena e aktit të parë
Ballafaqohej
Me gjakun dhe dhembjen

Ku ishit ju kur na i përtypën eshtrat
Me ingranazhet e ndryshkura
Ku ishit ju
Që sot paraqiteni në aktin e parë

SA QË PEMËT NGRIHESHIN

Më duket se u linda
Dhe do të vdes pa asnjë stinë
Pranverat ishin tepër të largëta
Kurse dimrat
Ngarkuar me ngricën
Dhe acarin e paparë të Prishtinës

Sa herë që i zgjata duart
Ta zë pranverën
Lukuni cerberësh më vinin pas
Kurse stinët e egra iknin para meje
Kallkanët zgjoheshin-lugat
Më mbulonin me thasë

Asnjëherë stina s'çeli lule në derë
Dimri pështynte pjalm dëbore
Kurse jeta ime u shndërrua
Në helm e vrer
Sa që pemët ngriheshin
Pa lulëzuar askurrë nëpër oborre

GJËMA ASNJËHERË S'PUSHOI

Po ngufatem si bretkosa
Në pellgun e thellë të pikëllimit
Nën pemët e prera
Nuk mbeti asnjë lejlekët
Sivjet vjeshta fshehurazi i lau sytë
Nën pjergullën e fshatit flenë pëllumbat

Kaluan disa ditë
Bile edhe mote të liga
Gjëma asnjëherë s'pushoi
Në buzët e ndryshkura të përroit
Laraskat i lënë vezët dhe ikën
Ikën përtej mjegullave të përhitura

Kurse ne shkisnim si kripa nëpër lima
Peshqit nëpër tasat e konservave
Ishin zvogëluar e tharë
Asgjë nuk iu kujtohet fanarëve
Për përmbytjen e anijeve
Nuk kishte mbetur asnjë dëshmitarë

DËGJOHEJ FRYMËMARRJA E UJIT

Posa dola nga një baladë e vjetër
Hyra në tjetrën
Aq shumë ishin të dehura enigmat
Sa që parathëniet e fjalëve
Gjatë tërë kohës kafshonin njëra-tjetrën

Rruga ishte e gjatë tepër e gjatë
Deri te portat e hapura
Ne nuk kishim kohë për të humbur
Andaj as që na shkoi ndërmend
Të trokasim në ndërgjegjen e pemëve

Nën qemerët e një ure të drunjtë
Dëgjohej zëri melankolik
I një qemaneje
Kurse nga llamburitja e kujtesës
Si uragan zgjohet frymëmarrja e ujit

Prishtinë, 24 maj 2016

NGJANË ME LEHJET E MJEGULLAVE

Sivjet vjeshta erdhi shumë herët
Më duket se pranvera
Asnjëherë nuk ishte këtu
Sa për stinët e tjera i lëmë të kullosin në hënë

Në lagjen tonë nuk rriten trëndafilat
Jeta na mësoi për vrazhdësinë e drurëve
Rrapet ka kohë që duken të lodhur
Ose ikën të gjithë nga qyteti

Më duket se po më mbaron durimi
Çdo lëvizje e degëve
Ngjanë me lehjet e mjegullave
Po ashtu edhe të trishtimeve

Njerëzit këtu kanë harruar
Se kur për herë të fundit u falën
Ose bënë kryq para oltarit të rrënuar
Harruan se si duken varret e vithisura

NËNA IME ISHTE NJË GRUA E MADHE

Gjithmonë më është dukur
Se kurrë nuk do të rritem
Sa e sa herë
I kreha flokët në ujë
Por kurrë nuk xhelozova
Në hijen e pasqyrës në mur

Nëne ime ishte një grua e madhe
Më mësoi kur isha tepër i vogël
Më mësoi artin e dashurisë
Sa që kurrë më nuk pata nevojë
T'i thyej gishtat
Pranë shelgjishteve të njoma

Tani kur u rrita pakëz më shumë
Se sa që duhej
Plepat e fëmijërisë
Më dukeshin më të vegjël
Edhe era i thyente gishtat e holla
Skuqej si vezët e ngjyrosura për festë

ASKUSH NUK THOTË MIRUPAFSHIM

Kur vjen koha ajo e vdekjes
Për herë të fundit
Druri i jetës lulëzon në kopsht
Sipas një rregulli të pashkruar asnjëherë
Lulëzojnë edhe pemët e egra

Ju thashë që më parë
Kur vjen ajo kohë e cila ndizet si qiriu
Në syrin e shandanit
Njerëzit parakalojnë pranë varrit tim
Të veshur me këmisha të bardha

Kam parë se si hesht procesioni
I ka hapat e gurta
Shkel mbi kalldrëmet ilire
Kalon nëpër bardhësinë e gurëve si dhelpra
Nëpër akull mbi një dimër të pafundmë

Në udhëtimin e fundit
Askush nuk thotë mirupafshim
Aq shumë i frikohen vdekjes
Sa që asnjërit nuk i bie ndërmend Parajsa
Mbase kanë shumë qejf të jetojnë në këtë ferr

ZË NJERIU DËGJOHET TE ULLINJTË

Kot trokas te portat e drurit
Sonte nuk hapen degët
Një zjarr i padukshëm me qindra vjet
Digjet në shpirtin e rrënjëve

Kambanat e mykura heshtin
Zë njeriu s'dëgjohet te ullinjtë
Para lindjes së agimit
Paskan vdekur edhe perënditë

Asnjë njeri nuk doli te sheshi
Përmendoret e bronzta
I fshinë djersët e ballit
Një shi i çmendur troket te lisat

Askush nuk i dëgjon të trokiturat
Ndoshta kanë vdekur edhe zërat
Një heshtje e tunxhtë
Përgjon kambanoren e fjetur

PËR NJË TË NESËRME TË MADHE

Këtu ndoshta pakëz më tutje
Te ajo shkurre e cila s'bëzan
E lashë plakun tim
E lashë shtrimë
Mbi bujarinë dhe shpirtin e Pollogut

Atë ditë nën stërkalat e shiut
I varrosëm duart e rrudhosura të trishtimit
Më kujtohet kur në trenin e çmendur
Për në Bllacë e zuri gjumi
Flinte si një kërthi mbi rrotat e dhembjes

Kur mbërrimë në këtë lëndinë
I dëgjuam britmat e Kaçanikut
Një zë çjerrës atë ditë
U zgjua si klithmë shpirti
Mbi supet e përgjakura të atdheut
Dëgjuam lehjet e cerberëve

Ai burrë i mirë i njihte në gishta
Dredhitë dhe luftërat ballkanike
U shtri përbri një rrapi
U shtri dhe mbeti aty si një përmendore
Për një të nesërme të madhe
Prishtinë, 25 maj 2016

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT:

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.

17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010

33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012

65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014

97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë.
142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë.

PËRMBAJTJA:

Trenat këtu gjithmonë vonohen
Cikli i parë..... 15

Nga sytë e plepave 17
Si syri i xhamtë i një parafjale 18
Këtu paskan vdekur fjalët 19
Në sytë romboide të ditës 20
Kjo shije e ujit të akullt 21
Mbi syprinën e detit të shterur 22
Atë ditë binte një shi i hidhur 23
Përpos frymëmarrjes sime 24
I ngrohin hijet e mykura 25
Ti dhe ëndrra e jote 26
Atdheu lahej në trishtim 27
Nesër do të këndojmë për atdheun 28
Ndonjëherë ngjajnë me drurët 29

Sa herë që i murosëm dhembjet 30
Kurse shiu alegorik 31
I kyç llambat e nostalgjisë 32
Fluturimet e avionëve prej letre 33
Këtu trenat gjithmonë vonohen 34
Por gjithsesi ishte lule 35
As nuk dinë të udhëtojnë 36
E herë nga palca e tokës 37
I ngjajnë luleve të verdha në vjeshtë 38
Ikën edhe qyqet nga ky shkretim 39
Pranë një busti prej bronzi 40
Një zë prej baritoni 41

Secili trembet nga hija e vet
Cikli i dytë 43

Asnjë njeri nuk qante 45

I zgjasin duart e pashpresë 46
Mbase qenkan shkundur stinët 48
Sa herë që kishim uri 49
Sërish dimri si bisha e egër 50
Për besë nga ky tog me baltë 51
Më duken si kolonadat antike 52
Shikonte para vetes detin e varfërisë 53
Kujtimet janë aq të freskëta 54
Të vegjlit 55
Secili trembet nga hija e vet 56
Unë s'jam çam as kosovar 57
Palltoja ime e vjetër 58
I dëgjonim edhe britmat e plumbave 60
Mbi këto bedena të atdheut 61
Sa i bukur duket atdheu im dardan 62
Çelin me qindra zogj të rinj 63

Koha e humbur sorollate 64
Si në ndonjë funeral i ndezi qirinjtë 65
Sërish një prekje e akullt 66
Por gjithsesi ishte dimër 67
Përpos një nëne të moshuar 68
Ngjan me ruletin rus 69
Dhoma e madhe ma zë frymën 70
Kurse tangoja e jonë sapo ka filluar 71
Përroi këndon një këngë të lashtë 72

Ne gjithmonë vuajmë
Cikli i tretë 73

Sa herë që shkuam nëpër varre 74
E kapërcyem të pamundurën 76
Ne i shkundëm pemët atë ditë 77
Ose çdo gjë ishte 78

Kur në fund të rrugës 79
Mes librave jetoj si Krishti me kryqin 80
Laraskat e të gjitha llojeve 81
Ashtu siç nuk më pëlqejnë as muret 82
Tok me shpirtin tim endacak 83
Ne gjithmonë vuajmë 84
Herë lindim nga fjala 85
Ku ishit ju 86
Sa që pemët ngriheshin 87
Gjëma asnjëherë s'pushoi 88
Dëgjoheshin frymëmarrjet e ujit 89
Ngjan me lehjen e mjegullave 90
Nëna ime ishte një grua e madhe 91
Askush nuk thotë mirupafshim 92
Zë njeriu dëgjohet te ullinjtë 93
Për fëmijët që do të vijnë nesër 94

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Trenat këtu gjithmonë vonohën/ Adem Zaplluzha. – Prishtinë : "Trend", 2017. – 108 f. ; 20 cm.

ISBN 978-9951-694-78-0